



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 334/1 prot.

Tiranë, më 30.01.2026

VENDIM

Nr. 02, datë 30.01.2026

PËR KONTROLLUESIN “ENGINEERING ALBANIA” SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Engineering Albania” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 152, datë 02.09.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e tyre, veçanërisht sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMIS).*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me numër identifikimi M32427009I, në Tiranë, i cili ka si objekt aktiviteti: “Dizajni, prodhimi, furnizimi, instalimi, menaxhimi dhe asistenca për programe softueri, pajisje dhe sisteme të ndërlidhura etj.”

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “klientë”, “punëmarrës”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka të instaluar një sistem video-survejsimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme ku ushtron aktivitetin. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, Kontrolluesi ka vendosur tabelë informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit, por nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, në kundërshtim me nenin 13 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejsimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të kontrollit, “Rregullore për zbatimin e mbikëqyrjes me video”, konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi referuar nenit 15 të Rregullores “Sistemi i mbikëqyrjes me video” sistemi lejon arkivimin e regjistrimeve video pa audio për 90 ditë, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të nenit 3 “Afati i ruajtjes”, të Udhëzimit nr. 3.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejsimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejsimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejsimit, të miratuar nga Komisioneri.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se periudha e mbajtjes së të dhënave në sistemin e video-survejsimit (CCTV), nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video-survejsimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video-survejsimit duhet të ruhen për një periudhë deri në një muaj dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar, duhet të realizohet shkatërrimi i të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

3. Kontrolluesi ka publikuar në faqen zyrtare eng.it/en/group/companies/engineering-albania, rubrikën “Politikat e Privatësisë”, të cilat janë modele standarde ndërkombëtare të politikave të privatësisë.

Sa më sipër, subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje), etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrimin që të publikojë *“Politikën e Privatësisë”*, të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

4. Kontrolluesi ka nënshkruar një marrëveshje me *“Qendrën e Mjekësisë së Punës”* sh.p.k, me objekt: *“Për ofrimin e shërbimeve nga Qendra e Mjekësisë së Punës shpk ndaj punonjësve të Engineering Albania shpk”*.

Nga analizimi i përmbajtjes së marrëveshjes, rezulton se, nuk janë reflektuar detyrimet dhe përgjegjësitë mes kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe përcaktimeve të Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me nenin 26 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk disponon *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”* (në vijim, *“Vendimi nr. 6”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregullore specifike *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura tekniko-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, (për çdo kategori subjektësh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda, që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Kontrolluesi disponon politika të Engineering Albania dhe Engineering Group lidhur me sigurinë e informacionit, konkretisht:

- Rregullore për zbatimin e mbikëqyrjes me Video;
- Vlerësim i ndikimit të mbikëqyrjes me video mbi privatësinë e Engineering Albania shpk;
- Grupi i inxhinierisë “Vlerësimi i Ndikimit të Transferimit”;
- Autorizim për akses në Data Center/dhomën e serverave;
- Politika për akses dhe përdorim të të dhënave konfidenciale, dt. 09.04.2024;
- Manuali i Sigurisë;
- ISM05 Politika e Menaxhimit të Incidentëve të Grupit;
- Politika e Sigurisë së Infrastrukturës së Grupit;
- Informacion mbi përpunimin e të dhënave personale për hyrjet dhe navigimin e serverave dhe infrastrukturave kritike dhe me rrezik të lartë të sulmeve kibernetike;
- Manual i sigurisë.

Rezulton se, mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si, “*Kontrolli i sigurisë së sistemit të arkivimit të të dhënave personale*”, “*Analiza e riskut është pjesë përbërëse e PSI-së*”, “*Hapat që duhet të ndërmerren në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Konstatohet se, masat e ndërmarra janë jo të plota në raport me veprimtarinë e gjerë që kryen Kontrolluesi, sikurse edhe grupi i politikave që disponon, nuk aplikohen dhe dokumentohen gjatë ushtrimit të aktivitetit, pasi ky set politikash i atribuohet kompanisë Engineering Group dhe nuk parashikojnë proceset përpunuese që kryhen nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit, si dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në zbatim të nenit 34 dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 48”*), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit janë paraqitur në seancën dëgjimore datë 20.10.2025, dhe kanë depozituar pretendimet me shkrim, si dhe dokumentacion plotësues mbi konstatimet e procesverbalit të hetimit administrativ. Kontrolluesi parashtoi argumentet e përmbledhura dhe pretendimet me shkrim mbi konstatimet e procesverbalit, si më poshtë:

- Lidhur me konstatimin për tabelën informuese për video-survejin (CCTV) dhe afatin e ruajtjes, Kontrolluesi argumenton se, *“Në vijim të konstatimeve të Komisionerit lidhur me tabelën informuese, që prej datës 10 Tetor 2025, shoqëria ka vendosur tabelën informuese sipas modelit standard të miratuar me Udhëzimin nr. 3, të Komisionerit, në hyrje dhe në zonat e mbuluara nga kamerat. Sa i përket afatit të ruajtjes së të dhënave personale, shoqëria ka zbatuar një afat të unifikuar ruajtjeje prej 7 (shtatë) ditësh për të gjitha regjistrimet CCTV, duke përditësuar Rregulloren për Zbatimin e Mbikëqyrjes me Video, në përputhje me nenin 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejit”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është në funksion, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejimit, të miratuar nga Komisioneri.

Gjithashtu, të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video-survejitimit duhet të ruhen për një periudhë deri në një muaj dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizohet shkatërrimi i të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit dhe të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

- Lidhur me konstatimin për publikimin e politikave të privatësisë, Kontrolluesi argumenton se, *“Kjo faqe interneti është një nën-faqe e asaj të Engineering Group. Në faqen e internetit të Engineering Group janë publikuar disa Politika të Privatësisë, në varësi të llojit të përpunimit të të dhënave dhe të kategorive të subjekteve të të dhënave të përfshira:*
 - *Politika e Privatësisë e parë, e cila gjendet në <https://www.eng.it/en/legal/privacy-policy> i referohet përpunimit të të dhënave personale që kryhet përmes navigimit në faqen e internetit; Politikat e tjera të Privatësisë të cilat gjenden në <https://www.eng.it/en/legal/informative-privacy> i referohen veprimtarive specifike të përpunimit dhe kategorive specifike të subjekteve të të dhënave (p.sh. klientë & partnerë, kandidatë, furnitorë, etj.)...”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Referuar Ligjit, Kontrolluesi duhet të hartojë dhe publikojë një politikë të privatësisë specifike, të qartë dhe të përshtatur për veprimtarinë e tij, duke reflektuar të gjithë elementët e nenit 13 të Ligjit. Pavarësisht ekzistencës së politikave të përgjithshme në faqen e *“Engineering Group”*, Kontrolluesi duhet të hartojë një politikë të privatësisë të dedikuar dhe të përshtatur për faqen e tij të internetit, për proceset konkrete të përpunimit.

Publikimi i politikave të përgjithshme të një grupi ndërkombëtar nuk e përmbush këtë detyrim ligjor, nëse këto politika nuk pasqyrojnë qartësisht identitetin dhe kontaktet e kontrolluesit në Shqipëri, aktivitetet specifike të tij, bazat e ligjshme dhe qëllimet përkatëse të përpunimit, transferimet ndërkombëtare të të dhënave (kur ato ekzistojnë), marrësit konkretë, përpunuesit lokalë të të dhënave, periudhat reale të ruajtjes për proceset që zhvillon vetë subjekti.

Gjithashtu, Kontrolluesi i referohet *Engineering Group* si një entitet i vetëm dhe sipas nenit 13 të Ligjit kërkohet që politikat e privatësisë të jenë të personalizuar për proceset konkrete të Kontrolluesit, të përditësuara sipas legjislacionit vendas, të aksesueshme drejtpërdrejt në faqen e internetit të Kontrolluesit, si dhe të hartuar në gjuhën shqipe.

- Lidhur me konstatimin për rregulloren për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, Kontrolluesi argumenton se, *“Shoqëria ka miratuar modelin organizativ të privatësisë dhe një sërë procedurash të brendshme të cilat rregullojnë aspektet që lidhen me të dhënat Personale, Menaxhimi i të Drejtave të Subjekteve të të Dhënave, (ky dokument është vënë tashmë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ). Rregullore të tjera, përkatësisht Politika e*

Ruajtjes së të Dhënave dhe Privatësia me dizajn dhe parazgjedhje, Vlerësimi i Ndikimit në të Dhënat Personale, janë aktualisht në proces zbatimi dhe trajtojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave by design dhe by default...”

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Dokumentet e depozituara nga Kontrolluesi, ashtu sikurse citohet dhe në pretendimet e tij, janë “*në proces hartimi*” dhe një pjesë i referohet politikave të grupit, çka tregon se në momentin e kryerjes së hetimit administrativ, Kontrolluesi nuk dispononte rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale. Hartimi i një rregulloreje specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” përbën një detyrim thelbësor ligjor për çdo kontrollues, në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

Kjo rregullore duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të kontrolluesit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda, që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

- Lidhur me konstatimin për trajnimin e punonjësve, Kontrolluesi argumenton se, “*Shoqëria zhvillon trajnime të rregullta për mbrojtjen e të dhënave për të gjithë punëmarrësit. Programet e trajnimit mbulojnë parimet thelbësore të mbrojtjes së të dhënave personale, bazat ligjore të përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave, masat e sigurisë, raportimin e incidenteve, si dhe politikat/procedurat e brendshme. Pjesëmarrja është e detyrueshme, përfundimi i moduleve evidentohet/ndiqet dhe seancat përditësuese planifikohen periodikisht, për të siguruar përputhshmëri të vazhdueshme...*”

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pretendimi i Kontrolluesit nuk qëndron. Gjatë hetimit administrativ nuk u paraqitën prova dhe materiale që të dokumentonin planin vjetor të trajnimeve, listat e pjesëmarrësve, regjistrimet e moduleve të përfunduara, materialet e trajnimeve, evidenca të testimeve apo vlerësimeve të përfundimit të trajnimit, etj.

Gjithashtu, moduli i trajnimit i vendosur në dispozicion në seancë dëgjimore, është një material trajnimi i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave personale që aplikon grupi në kuadër të GDPR (Rregullorja (BE) 2016/679). Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka vendosur në dispozicion evidenca/procesverbale ku të vërtetohen se janë kryer trajnime të punonjësve. Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

“1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:

a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;

2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:

a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;

b) shkeljet e të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas neneve 12–20 të këtij ligji;”.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike, që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje, Zyra e Komisionerit evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e Kontrolluesit. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë xhiron vjetore të deklaruar nga Kontrolluesi, si dhe rëndësinë e proceseve përpunuese.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, “Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”, veçanërisht në pikat 7 dhe 8, të Seksionit 2.3 të Kapitullit 2 dhe të Kapitullit 4, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente masën e sanksionit administrativ ndaj Kontrolluesit, sipas përcaktimeve të nenit 94 në harmoni me nenin 93 të Ligjit, duke u bazuar në kufijtë minimalë të përllogaritjes.

Komisioneri vlerëson faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu,

vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 28, 34, 81-84, 87 pika 1, nenit 93, shkronjës “a” të pikës 1 dhe shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 94, si dhe nenit 95 të Ligjit, dhe të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **2,200,000** (dy milion e dyqind mijë) lekë, për shkelje të neneve 6 dhe 13 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **1,100,000** (një milion e njëqind mijë) lekë, për shkelje të neneve 26 dhe 28 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për publikimin e “Politikave të Privatësisë” në faqen e internetit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
7. Kontrolluesi, të marrë masa lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre, sipas parashikimeve të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 34 të Ligjit;

8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;¹
9. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;²
10. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
- i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 më sipër;
 - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër;
 - iii. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 7 dhe 8 më sipër.
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
11. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;
12. Vendimi për gjobë përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga kundërvajtësi (Kontrolluesi), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Për ekzekutimin e gjobës ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor;
13. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit të këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 30.01.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

¹ Udhëzimi nr. 47 dhe Udhëzimi nr. 48 janë shfuqizuar me Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues”;

² Detyrimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 5, të udhëzimit nr. 48, vijnë sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 9, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale”.